Dhjetor 2015

# Instituti GAP në vitin e 8

INSTITUTI GAP gap

“Instituti GAP synon që të mbushë hendekun në mes të qeverisjes dhe qytetarëve, në mes të problemeve dhe zgjidhjeve, me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Këtë e bëjmë duke avokuar për një qeverisje më të mirë, duke monitoruar punën e institucioneve publike, dhe duke rekomanduar zgjidhje konkrete mbi politikat publike. Instituti GAP adreson sfidat ekonomike, politike dhe sociale në vend duke mobilizuar profesionistë të fushave të ndryshme.”





“Instituti GAP një nga Think Tank më me ndikim në Kosovë - që promovon zhvillimin ekonomik të këtij vendi” Sekretari John Kerry duke prezantuar, Nora Latifi - Menaxhere e programit GAP, gjatë vizitës së tij në Kosovë. 2 Dhjetor 2015

# Hyrje

Viti 2015 ishte viti i tetë i funksionimit të Institutit GAP. Edhe në vitin e tetë, Instituti GAP ka vazhduar punën në përmbushjen e misionit të tij, si një organizatë jo qeveritare, me vizion për të kontribuuar në ndërtimin e një shteti demokratik, i cila garanton liritë individuale, politike dhe ekonomike të secilit anëtar të shoqërisë.

Në frymën e vizionit tonë, në vitin 2015, përmes analizave, raporteve, konferencave e debateve, paraqitjeve mediatike e pjesëmarrjes në grupe punuese qeveritare, Instituti GAP është përpjekur të mbushë hendekun në mes të qeverisjes dhe qytetarëve si dhe në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Gjatë vitit 2015, Instituti GAP ka publikuar 15 analiza dhe raporte rreth politikave publike, duke prekur temat më relevante rreth zhvillimit ekonomik, qeverisjes së mirë dhe mirëqenies së qytetarëve. Një seri e analizave gjatë këtij viti ka qenë e fokusuar në politikat fiskale dhe llogaridhënien buxhetore, si dy kritere të rëndësishme që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Klima e investimeve në Kosovë, gjendja e prodhuesve vendor, dhe fondet qeveritare për garanci kreditore, po ashtu janë analizuar gjatë këtij viti. Edhe tema të tjera si, efiçienca e energjisë, reformimi dhe profesionalizimi i administratës publike, qeverisja e mirë në nivelin lokal, kanë qenë në fokus të analizave të Institutit GAP.

Gjatë këtij viti, Instituti GAP ka organizuar 12 konferenca dhe debate për të diskutuar idetë, zgjidhjet dhe rekomandimet e ndryshme me vendimmarrësit kosovar dhe përfaqësuesit e institucioneve të huaja në Kosovë. Instituti GAP mbetet një ndër organizatat me pjesëmarrjen më të lartë në diskutimet zyrtare të politikave, me dhjetëra paraqitje e pjesëmarrje në dëgjime publike dhe grupe punuese.

Instituti GAP ka arritur të dallohet edhe si organizata më e cituar nga mediat vendore dhe ndërkombëtare, me mbi 700 paraqitje mediatike në vit, si dhe me numrin më të madh të vizitorëve në platformat elektronike dhe mediat sociale.

Kontributi profesional i Institutit GAP është vlerësuar nga zyrtarë të lartë qeveritarë, deputetë të parlamentit, kryetarë të komunave, si dhe nga përfaqësues të institucioneve të huaja. Gjatë fjalimit të tij në Kosovë, John Kerry, Sekretari Amerikan i Shtetit, e ka vlerësuar Institutin GAP si "një nga think tank-ët më me ndikim në Kosovë".

Për organizatën tonë, e gjithë kjo e bën vitin 2015 si një vit mjaft të suksesshëm dhe produktiv. Një sukses i tillë do të ishte i pa mundur pa një staf profesional dhe pa mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve dhe donatorëve tonë.

# 1. Kontributi i Institutit **GAP** në politikën fiskale dhe procesin buxhetor

**“Instituti GAP angazhohet për një proces buxhetor të drejtë, transparent dhe në funksion të zhvillimit ekonomik.”**

Këtë e bëjmë duke:

- **Monitoruar të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;**
- **Publikuar analiza dhe rekomandime për përmirësimin e procesit buxhetor;**
- **Vlerësuar ndikimin ekonomik dhe financiar të vendimeve qeveritare;**
- **Avokuar për transparencë më të madhe, si formë për luftimin e korrupsionit;**

- Vizualizuar të dhënat buxhetore me qëllim të edukimit të gjerë të publikut;

- Inkurajuar institucionet për të mbajtur diskutime publike me qytetarët;

- Bashkëpunuar me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin buxhetor në nivel lokal dhe qendror;

- Edukuar qytetarët për procesin buxhetor, përmes prezanti meve në universitete, shkolla dhe forume me grupe të ndryshme të qytetarëve;

- Asistuar deputetët dhe komisionet parlamentare në analiza sektoriale buxhetore, me qëllim të mbajtjes përgjegjës të institucioneve ekzekutive.

# 1.1 Kontributi i Institutit GAP në politikën fiskale

Në vitin 2015 janë bërë reformat më të thella në politikën fiskale që nga viti 2008. Qeveria e Kosovës ka ndryshuar Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Instituti GAP ka kontribuar në diskutimet për këto projektligje në kohën kur ato janë dorëzuar në kuvend për diskutim dhe aprovim, duke i informuar deputetët për ndikim real të këtyre ligjeve në çmimet e konsumit, të hyrat buxhetore dhe në koston e të bërit biznes.


INSTITUTI GAP

Efektet Ekonomike dhe Buxhetore të Reformave Fiskale 2015

Qershor, 2015

**Efektet ekonomike dhe buxhetore të reformave fiskale 2015**

Në qershor të vitit 2015, Instituti GAP informoi deputetët e kuvendit për ndikim real që do të kishin ligjet për reformën fiskale në ekonomi.

“Sipas një raporti që e ka bërë Instituti GAP, ku e vlerëson reflektimin buxhetor që do të kenë këto ndryshime në tatimin në vlerë të shtuar, aty thuhet se... duke i marrë për bazë të dhënat e Doganave për vitin 2014, efekti neto negativ, pra nga ulja e tatimit në vlerë të shtuar prej 16 në 8%, në buxhetin e Republikës së Kosovës, do të jetë diku 5 milionë euro, ndërkohë që efekti pozitiv për shkak të rritjes nga 16 në 18%, do të jetë mbi 50 milionë euro. Këtu shihet qartë, domethënë që do të ketë një ndikim në shportën e konsumatorit, të cilat sipas Institutit GAP gjithnjë, do të shtrenjtohet përgjithësisht për 1% me këto ndryshime tatimore, pra konsumatorët do të paguajnë më shtrenjtë për shportën e tyre se sa që paguajnë aktualisht.”

-Visar Ymeri, deputet i Kuvendit të Kosovës, gjatë fjalimit të tij në seancë parlamentare të datës 28 maj 2015.

*Përderisa Ministria e Financave deklaronte se normat e reja të tatimit mbi vlerën e shtuar do të ulnin çmimet dhe do të ndihmonin qytetarët me të ardhura më të ulëta, të dhënat e Institutit GAP paralajmëronin të kundërtën: se çmimet e konsumit, edhe për shportën bazë, do të rriteshin së paku për një përqind.*

Hyrja në fuqi e këtyre ligjeve nga 1 shtatori 2015, dëshmoi të gjeturat e Institutit GAP, ngase çmimet u rritën, në kundërshtim me analizat e Qeverisë. Kjo u pranua zyrtarisht edhe nga anketa e Agjencisë së Statistikave të Kosovës në dhjetor 2015.

## Kush do të përfitojë nga falja e borxheve?

Në shkurt të vitit 2015, Qeveria e Kosovës filloi procedurat për faljen e borxheve që qytetarët dhe bizneset i kishin shtetit deri më 2008.




Sipas analizave të qeverisë, do të faleshin rreth 670 milionë euro.

Instituti GAP mbështeti këtë vendim të qeverisë. Që nga marrja e vendimit të qeverisë, Instituti GAP filloi të kontaktojë të gjitha institucionet publike, me qëllim të marrjes së të dhënave të sakta për nivelin e borxhit. Në këtë proces, problemet që u identifikuan ishin se institucionet publike nuk kanë mbajtur të dhëna të detajuara për borxhlinjtë dhe se nuk i kanë ndjekur procedurat ligjore për mbledhjen e të hyrave.

Rrjedhimisht, borxhi i cili mund të mbledhej përmes procedurave ligjore nuk ishte 670 milionë euro por shumë më i vogël. Qeveria do të mund të falë vetëm borxhin për të cilin ka padi në gjykata.

Përfundimet e analizës së Institutit GAP ishin:

*institucionet nuk kanë kryer punën e tyre në evidentimin dhe grumbullimin e borxhit; përfituesit më të mëdhenj nga falja e borxheve do të jenë amvisëritë; një pjesë e madhe e borxhit të cilin qeveria synon ta falë është vjetërsuar dhe nuk mund të mblidhet as me procedura gjyqësore.*

Gjatë përpilimit të raportit, Instituti GAP është asistuar nga Ministria e Financave, Doganat, Administrata Tatimore dhe ndërmarrjet publike.

## Sa janë reale projektimet dhe sa respektohen Kornizat Afat-mesme të Shpenzimeve (KASH)?

### Krahasimi i KASH me Projektbuxhetet

| | Të Hyrat | | | Shpenzimet | | | Paga | | | Investime kapitale | | | Mallrat dhe Sherbimet | | | Subvencionet & Transferet | | | Rritja reale e BPV-së | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vitet** | I | II | III | I | II | III | I | II | III | I | II | III | I | II | III | I | II | III | I | II | III |
| **KASH 2011 - 2013** | 1,150 | 1,263 | 1,356 | 1,423 | 1,520 | 1,571 | 316 | 351 | 378 | 611 | 650 | 641 | 193 | 206 | 220 | 279 | 289 | 309 | 6,1% | 5,7% | 4,9% |
| Projekt-Buxheti | 1,264 | 1,361 | 1,423 | 1,434 | 1,520 | 1,586 | 383 | 407 | 435 | 572 | 617 | 621 | 184 | 198 | 225 | 272 | 282 | 299 | 4,3% | 2,8% | 3,3% |
| **KASH 2012 - 2014** | 1,312 | 1,372 | 1,431 | 1,459 | 1,487 | 1,444 | 399 | 403 | 408 | 587 | 605 | 550 | 196 | 199 | 201 | 273 | 277 | 280 | 5,1% | 5,4% | 6,0% |
| Projekt-Buxheti | 1,361 | 1,423 | 1,458 | 1,520 | 1,586 | 1,590 | 407 | 435 | 484 | 617 | 621 | 531 | 198 | 225 | 252 | 282 | 299 | 314 | 2,8% | 3,3% | 2,7% |
| **KASH 2013 - 2015** | 1,411 | 1,468 | 1,499 | 1,548 | 1,585 | 1,608 | 440 | 445 | 448 | 620 | 625 | 637 | 204 | 207 | 211 | 287 | 304 | 309 | 4,9% | 5,6% | 5,8% |
| Projekt-Buxheti | 1,423 | 1,458 | 1,576 | 1,586 | 1,590 | 1,682 | 435 | 484 | 560,1 | 621 | 531 | 457 | 225 | 252 | 221,6 | 299 | 314 | 438,7 | 3,3% | 2,7% | 3,3% |
| **KASH 2014 - 2016** | 1,395 | 1,441 | 1,490 | 1,611 | 1,568 | 1,597 | 447 | 449 | 451 | 606 | 554 | 571 | 230 | 234 | 239 | 324 | 327 | 332 | 4,3% | 4,6% | 5,1% |
| Projekt-Buxheti | 1,458 | 1,576 | | 1,590 | 1,682 | | 484 | 560,1 | | 531 | 457 | | 252 | 221,6 | | 314 | 438,7 | | 2,7% | 3,3% | |
| **KASH 2015 - 2017** | 1,572 | 1,572 | 1,598 | 1,678 | 1,679 | 1,706 | 550,2 | 551,9 | 553,9 | 460,7 | 450,4 | 470,3 | 211,4 | 214,8 | 214,8 | 434,6 | 440,6 | 446,6 | 4,3% | 4,4% | 4,5% |
| Projekt-Buxheti | 1,576 | | | 1,682 | | | 560,1 | | | 457 | | | 221,6 | | | 438,7 | | | | | |

Projekt-Buxheti 2011
Projekt-Buxheti 2012
Projekt-Buxheti 2013
Projekt-Buxheti 2014
Projekt-Buxheti 2015

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA

Ministria e Financave e ka obligim ligjor hartimin e KASH-it, si një dokument zyrtar për planifikimin tre vjeçar të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

Por, KASH nuk po e luan rolin e synuar ligjor, për shkak të hartimit jo të mirë si dhe shkeljes së saj me vendimet qeveritare. Në maj të vitit 2015, Instituti GAP ka analizuar Kornizat Afatmesme që nga viti 2011 e këndej, duke argumentuar planifikimin jo të mirë dhe shkeljen e KASH-it me vendime qeveritare, sidomos me marrjen e vendimeve për rritjen e pagave për shërbyesit publik.

Për të evituar vendimet arbitrare për rritje të pagave, si masë për të respektuar ndarjet buxhetore dhe Kornizat Afatmesme, me këtë analizë të shkurtër, Instituti GAP rekomandoi vendosjen e një rregulli për rritjen e pagave në sektorin publik, i cili duhet të ndërlidhet me rritjen ekonomike. **Kjo rregull është përfshirë në ligjin e ri për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, e cili pritet të hyjë në fuqi nga viti 2018.**




## 1.2 Kontributi i Institutit GAP në diskutimet parlamentare për buxhetin

Ligji për buxhetin është një ndër ligjet më të rëndësishme në Republikën e Kosovës. Por përkundër kësaj, procesi i konsultimeve për ndarjet buxhetore, në nivel lokal, qendror dhe në kuvend, është një ndër proceset më jo transparente dhe ku publiku përfshihet në raste të rralla. Po ashtu, edhe deputetët e kuvendit nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur konsultimeve buxhetore.

Për të ndryshuar këtë praktikë, gjatë vitit 2015, Instituti GAP ka asistuar deputetët dhe komisionet parlamentare me analiza të pavarura për raportet buxhetore për vitin 2015 dhe ndarjet buxhetore për vitin 2016.

a. **“Analiza Buxhetore për Komisione Parlamentare Lidhur me Shqyrtimin e Projekt-buxhetit 2016”.**

Gjatë kohës që Kuvendi i Kosovës ka shqyrtuar projekt-buxhetin 2016, Instituti GAP gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2015, ka përgatitur gjashtë analiza buxhetore për këto komisione:

**I. Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**

**II. Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**

**III. Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport;**

**IV. Komisionin Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinorë;**

**V. Komisionin për Legjislacion;**

**VI. Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.**

Nga këto gjashtë analiza të dërguara, pesë komisione kanë organizuar për herë të parë dëgjime lidhur me sfidat buxhetore me ministra dhe udhëheqës të institucioneve të pavarura të cilat mbikëqyren nga komisionet përkatëse.

b. **Analiza për “Projektbuxhetin 2016 – përparësitë dhe sfidat”. – Nëntor 2015.**

Instituti GAP ka përgaditur një analizë për Projektbuxhetin 2016, e cila fokusohe në ndarjet buxhetore për komuna dhe ndërlidhja e buxhetit me planet tjera qeveritare, sfidat e Raportit të Progresit dhe ligjet në fuqi. Sipas të gjeturave në këtë analizë, ndarja buxhetore për komuna nuk është e drejtë. Buxheti 2016 nuk garanton zbatimin e të gjitha ligjeve në fuqi, nuk i adreson objektivat e parapara me Planin Kombëtar për Reforma Ekonomike dhe sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën 2015. Kjo analizë i është shpërndarë të gjithë deputetëve pas leximit të Projektligjit për Buxhetin 2016 në lexim të parë në kuvend.

## 1.3 Vizualizimi i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore



Që nga viti 2013, Instituti GAP ka ndërtuar një ndër platformat më të mëdha online, e cila raporton në mënyrë vizuele për shpenzimet dhe të hyrat buxhetore. Në këtë platformë të titulluar "Si i shpenzon shteti paret tona?", në mënyrë vizuele janë paraqitur ndarjet kryesore buxhetore, krahasimi i tyre në pesë vitet e fundit, buxhetet për komuna, institucione qendrore dhe agjencione të pavarura. Përveç ndarjeve buxhetore sipas organizatave, përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, Instituti GAP ka arritur që të paraqesë të dhëna për shpenzime buxhetore të cilat nuk mund të gjenden në raportet periodike të Ministrisë së Financave dhe organizatave tjera buxhetore. Duke kërkuar qasje në shpenzimet individuale të secilit të emëruar politik, që nga viti 2013, Instituti GAP publikon të dhëna për shpenzimet e të gjithë ministrave dhe zëvendësministrave për dreka zyrtare, telefona, mëditje dhe përdorim të veturës zyrtare.

*Përkundër asaj se pjesa më e madhe e institucioneve përgjigjen në kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, edhe më tej është një numër i madh i institucioneve të cilat nuk kthejnë përgjigje konform Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare apo kthejnë përgjigje te pjesshme.*

Platforma e Institutit GAP për shpenzimet dhe të hyrat buxhetore është vizituar nga mijëra persona në vitin 2015, si dhe 25 komuna të Kosovës kanë ndërlidhur platformën e Institutit GAP me uebfaqet e tyre zyrtare.

Platforma e Institutit GAP ka ndihmuar në rritjen e transparencës për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, thjeshtëzimin e raportimit buxhetor me qëllim që të kuptohet nga masat më të gjera dhe si mjet për lehtësimin e analizave buxhetore dhe trendit të të hyrave dhe shpenzimeve.

# 1.4 Avokimi për një proces gjithëpërfshirës dhe transparent buxhetor

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Agjencionin Gjerman për Zhvillim (GIZ), Instituti GAP ka vazhduar me përpilimin dhe publikimin e infografikave dhe manualeve për procesin buxhetor.

Përveq kësaj, Instituti GAP ka mbajtur debate publike në gjashtë qytetet më të mëdha të Kosovës, ku në prezencë të kryetarëve të komunave, është diskutuar për rëndësinë e angazhimit të qytetarëve në procesin buxhetor në nivel lokal dhe aplikimin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe buxhetimit gjinor.




giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Republika e Kosovës
Ministria e Financave




german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

## 1.5 Fushatat edukues për procesin buxhetor

Me qëllim të rritjes së informimit për rëndësinë e pjesëmarrjes së të gjithë qytetarëve në procesin buxhetor dhe për të informuar ata për kontributin e tyre në buxhet, Instituti GAP ka mbajtur prezentime të shumta në qytete të ndryshme me grupe të ndryshme të qytetarëve. Prezantime të tilla janë mbajtur me studentët e universiteteve private, shkollave të mesme, grupe të të rinjsh dhe deputetë të kuvendeve komunale.



# 2. Kontributi i Institutit **GAP** në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik

**"Instituti GAP angazhohet për Kosovë të zhvilluar ekonomikisht, e cila është e konkurrueshme me ekonimitë e vendeve të rajonit dhe e gatshme për anëtarësim në tregun unik Evropian."**

Këtë e bëjmë duke:

- **Inkurajuar prodhimin vendor dhe arritjen e standardeve të cilësisë në prodhim;**

- **Kontribuar në politika të cilat ulin deficitin tregtar;**

- **Avokuar për politika energjetike të qëndrueshme;**

- **Ndihmuar në përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve publike, si ofrues të shërbimeve publike për qytetarë dhe biznese;**

- **Monitoruar punën e rregullatorëve të tregut, si trupa të rëndësishme publike të cilat sigurojnë pjesëmarrjen e barabartë të të gjithë akterëve në ekonomi.**

# 2.1 Politika të cilat inkurajojnë prodhimin vendor




## Seria e raporteve për gjendjen e prodhuesve vendor

Kosova përballet me papunësinë më të lartë në Evropë. Po ashtu, Kosova ka bilanc shumë të lartë negativ tregtar dhe prodhimtari të ulët.

Me qëllim që të rritet prodhimi vendor, si mënyrë për uljen e deficitit tregtar dhe rritjen e punësimit, Instituti GAP gjatë vitit 2015 ka filluar intervistimin e prodhuesve vendor, me qëllim të përpilimit të një serie raportesh për gjendjen e prodhuesve vendor, pengesat në prodhim dhe potencialet për zhvillim.

Deri më tani, Instituti GAP ka hartuar raporte për gjendjen e prodhuesve të materialit ndërtimor me bazë argjilën, prodhuesit dhe përpunuesit e lëngjeve nga frutat, përpunuesit e qumështit dhe prodhuesit e letrës. Në vitin 2016 do të vazhdohet me industri tjera prodhuese.

Raportet për këto industri prodhuese i janë dorëzuar Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

Në bazë të të gjeturave nga intervistat me prodhuesit vendor, Instituti GAP do të avokojë tek institucionet publike në evitimin e pengesave me të cilat përballen prodhuesit vendor, uljen e kostos së prodhimit dhe gjetjen e mundësive për qasje në financa me kushte më të favorshme.



## 2.2 Politika energjetike të qëndrueshme

Furnizimi i rregullt me energji është një ndër parakushtet e zhvillimit ekonomik dhe social. Instituti GAP, si pjesë e Konsorciumit të Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), që nga viti 2011 në mënyrë aktive ka avokuar për politika të qëndrueshme energjetike.

*Instituti GAP në kuadër të KOSID-it ka avokuar për politika të cilat sjellin mbylljen e Kosovës A si një ndër termocentralet më ndotës në Evropën Juglindore, revitalizimin e Kosovës B, uljen e humbjeve energjetike në nivel të pranueshëm me standardet evropiane, inkurajimin e investimeve në energjinë e ripërtërishme, rritjen e efiçiencës së energjisë.*

Instituti GAP ka avokuar për një strategji energjetike e cila përmban këto objektiva të zhvillimit të sektorit energjetik.



Në tetor, në një konferencë për media me përfaqësues të Komunës së Prishtinës dhe Ambasadës Gjermane në Kosovë, Instituti GAP ka prezantuar analizën **"Shfrytëzimi i Energjisë Elektrike për Ngrohje – ndikimi i kogjenerimit në konsum të energjisë"**. Në këtë analizë janë prezantuar rezultatet e anketës për ndikimin e ngrohjes qendrore në faturat elektrike. Instituti GAP ka rekomanduar zgjerimin e rrjetit të ngrohjes edhe në pjesë tjera të Prishtinës, si dhe investime në projekte të tilla në qytete tjera, si masë për uljen e konsumit të energjisë elektrike.

## 2.3 Ndërmarrje publike të cilat ofrojnë shërbime për qytetarë dhe biznese



Shërbimet publike si uji, energjia, telekomunikimi dhe mbledhja e mbeturinave, ofrohen nga ndërmarrjet publike. Mirëpo, menaxhimi i ndërmarrjeve publike është një nga sfidat kryesore të qeverisjes.

*Menaxhimi jo i mirë i ndërmarrjeve ka bërë që shumica prej këtyre ndërmarrjeve të operojnë me humbje, të jenë të mbingarkuara me staf dhe të politizuara. Furnizimi i rregullt me ujë dhe energji, si dhe ambienti i pastër, janë disa nga parakushtet për zhvillim ekonomik dhe social.*

Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve publike, gjatë vitit 2015, Instituti GAP ka publikuar tri raporte analitike për qeverisjen korporative, duke dhënë rekomandime konkrete për rritjen e performancës së ndërmarrjeve publike. Këto raporte janë prezantuar në diskutime publike, ku pjesëmarrës kanë qenë menaxherë të ndërmarrjeve publike, përfaqësues të komunave, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Kryetari i Komisionit parlamentar për Zhvillim Ekonomik.









# 2.4 Kontributi në vendimmarrje për politikat e ndërlidhura me zhvillimin ekonomik

Gjatë vitit 2015, Instituti GAP ka marr pjesë aktivisht në dëgjimet publike dhe grupet punuese për aprovim të politikave publike dhe legjislacionit në fushën e zhvillimit ekonomik.

**Fondi Kosovar për Granaci Kreditore – Modelet e menaxhimit dhe efektiviteti**




Më 9 shtator 2015, në një debat publik ku ishin të pranishëm ministrja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përfaqësues të bizneseve dhe bankave komerciale, Instituti GAP diskutoi për efektet që mund të ketë në ekonomi aprovimi i Ligjit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore.

Institui GAP ka përkrahur nismën e qeverisë për krijimin e një Fondi për Garanci Kreditore, por përmes kësaj analize ka tërhequr vërejtjen se një fond i tillë, nëse nuk menaxhohet si duhet, rrezikon të shndërrohet në instrument politik. Analiza e Institutit GAP i është dorëzuar edhe Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik. Në dëgjimin publik të organizuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 Tetor 2015 , Instituti GAP ka prezantuar edhe një herë rekomandimet për përmirësimin e draftit final të këtij ligji.

**Komentet e Institutit GAP dhe GLPS në Projektligjin për Investime Strategjike**

Në nëntor 2015, Qeveria e Kosovës aprovoi Projektligjin për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës. Instituti GAP në bashkëpunim me Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka dërguar komentet për përmirësimin e këtij projektligji, sidomos në ato pika të cilat vënë në rrezik pronën private, konkurrencën e lirë dhe standardet evropiane.

"Të njejtat komente i janë dërguar edhe Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri."

**Kontributi i Institutit GAP në Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike**

Në janar dhe shkurt të vitit 2015, Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik ka diskutuar për Ligjin për Ndërmarrje Publike.

Analizat e Institutit GAP për menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe legjislacionin në këtë fushë, kanë shërbyer si dokumente diskutimi gjatë punës së komisionit.

Rekomandimet e Institutit GAP janë prezantuar edhe në dëgjimin publik të mbajtur më 27 Shkurt 2015 nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik.

# 2.5 Politikat e importit të automjeteve dhe ndikimi i tyre në sigurinë në rrugë dhe ndotja e ambientit




Instituti GAP avokon politikat e importit të automjeteve të cilat plotësojnë standardet e Bashkimit Evropian për emetim të gazrave, rregullativë qeveritare e cila siguron se automjetet e regjistruara plotësojnë standardet e qarkullimit rrugor.

Instituti GAP ka kundërshtuar politikat e gjertanishme të qeverisë për heqjen e kufizimit të importit të automjeteve me qëllim të mbushjes së buxhetit të shtetit, anashkalimin e procedurave për matjen e emetimit të gazrave dhe mos mbikëqyrja e duhur e qendrave për kontrollin e automjeteve.

*Kosova ka shkallën më të lartë të aksidenteve në komunikacion për kokë banori në Evropë, si dhe gazrat e emetuara nga automjetet arrijnë mesatarisht në 1.5 milion ton CO2 në vit.*

Efektet anësore negative nga këto politika të qeverisë i tejkalojnë shumëfish përfitimet nga të hyrat buxhetore nga importi i automjeteve.

Instituti GAP rekomandon ndryshimin e politikave të importit, të cilat fokusohen në standardet e emetimit të gazrave (Euro standard) e jo në vjetërsinë e veturave. Njëkohësisht, Instituti GAP avokon për mbikëqyrje më të madhe të qendrave të kontrollimit teknik të automjeteve dhe kontrollin e detyrueshëm për emetimin e gazrave, para se veturat të lejohen të qarkullojnë në rrugë.

**Ekonomia e veturave në Kosovë - Analizimi i politikave qeveritare për importin, regjistrimin dhe kontrollimin e automjeteve**




Për të arritur këto, në tetor 2015, në një debat publik në prezencë të Minstrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Shefit të Departamentit të Sigurisë në Komunikacionin Rrugor në Policinë e Kosovës, u prezantua analiza e Institutit GAP "Ekonomia e veturave në Kosovë - Analizimi i politikave qeveritare për importin, regjistrimin dhe kontrollimin e automjeteve", e cila ofron zgjidhje për rregullimin e politikave të importit dhe kontrollit të automjeteve.

*"Sa i takon Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, janë përfunduar dokumentet e rëndësishme ligjore dhe strategjike, të cilat vënë rregull edhe në nivelin e emetimit të gazrave nga veturat. Mirëpo, zbatimi i bazës ligjore për emetimin e gazrave nga veturat është përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës, e cila duhet të monitorojë punën e qendrave të kontrollit teknik. Edhe pse udhëzimi administrativ është aprovuar më 2011, ky udhëzim nuk është zbatuar dhe MMPH është në proces të nxjerrjes së një udhëzimi të ri" – Ferid Agani, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në konferencën e Institutit GAP të datës 16 tetor 2015.*

Në takime të ndara, Instituti GAP ka takuar edhe Ministrin e Infrastrukturës dhe përgjegjësit e departamenteve për kontrollin dhe regjistrimin e automjeteve, zyrtarë të Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Financave.

Pas publikimit të analizës dhe fushatës avokuese, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka filluar përditësimin e udhëzimit administrativ për kontrollin e emetimit të gazrave, i cili pritet të hyjë në fuqi nga viti 2016.

# 3. Kontributi i Institutit **GAP** në reformimin e administratës publike

**“Instituti GAP angazhohet për administratë publike efikase, profesionale dhe jo të ndikuar politikisht, e cila garanton zbatimin e drejtë të ligjeve dhe është bartëse e reformave ekonomike.”**

Këtë e bëjmë duke:

- **Avokuar për një administratë profesionale dhe më të vogël me numër të punësuarish;**
- **Qeveri me numër më të vogël të portofoliove ministrore dhe me kompetenca të qarta;**

- **Procedura transparente dhe të drejta rekrutimi;**

- **Asistuar në shërbimet e e-qeverisjes.**

Administrata publike është sektor i rëndësishëm i shtetndërtimit. Por, fatkeqësisht, administrata publike në Kosovë është e tejngarkuar me staf, e politizuar, jo profesionale dhe jo e strukturuar drejtë. Në përkeqësimin e gjendjes në administratën publike kanë ndikuar edhe vendimet e qeverisë për rritjen e pagave pa ndonjë vlerësim profesional, rritjen e numrit të ministrive, punësimet në baza partiake dhe familjare, korrupsioni dhe procedurat e shumta burokratike të cilat janë pengesë në zhvillimin e ekonomisë.

Që nga viti 2008, Instituti GAP është aktiv në avokimin për një administratë më profesionale dhe efikase. Instituti GAP ka qenë pjesë e projektit ndërkombëtar FRIDOM – një ndër projektet më të mëdha në reformimin e administratës publike në Kosovë. Edhe në vitin 2015, përmes analizave dhe debateve, Instituti GAP ka avokuar për reforma në administratën publike.

## 3.1 Madhësia e Administratës Publike në Kosovë – propozim për uljen e të punësuarve në admini tratën publike




Në Kosovë ekziston një numër i madh i institucioneve të administratës publike, dhe një numër i madh i të punësuarve në të.

*Përkundër premtimeve për uljen e numrit të ministrive, qeveria aktuale vetëm sa ka shtuar numrin e ministrave – nga 20 në 21.*

Përveç kësaj, ministritë dhe Zyra e Kryeministrit kanë krijuar edhe mbi 70 organe qendrore të administratës shtetërore (apo agjenci ekzekutive), dhe po ashtu kuvendi ka krijuar 34 institucione dhe agjenci të pavarura. Sektori publik në nivel qendror dhe lokal numëron mbi 91 mijë të punësuar.

Në korrik 2015, Instituti GAP ka publikuar një raport të detajuar për strukturën e administratës publike në Kosovë, duke kërkuar edhe një herë uljen e numrit të dikastereve qeveritare, zvogëlimin e numrit të të punësuarve dhe ristrukturimin e agjencioneve ekzekutive.

## 3.2 Fondi për Kuadro – program financimi për pozita deficitare apo menaxheriale?




Në vitin 2008, Instituti GAP i kishte propozuar Qeverisë së Kosovës të themelojë një fond special buxhetor për të tërhequr ekspertë të fushave deficitare në shërbimin publik. Në këtë iniciativë, Instituti GAP i kishte ofruar Qeverisë një analizë të detajuar mbi nevojën e krijimit të një fondi të tillë dhe mënyrën se si do duhej të funksiononte ai fond.

Kjo ide u materializua në dhjetor 2008, kur Qeveria e Kosovës mori vendim për themelimin e Fondit të Trurit. Në vendimin e qeverisë u tha se kriteret precize për mënyrën e përzgjedhjes së përfituesve do të merren nga raporti i Institutit GAP.

*Por, Fondi për Kuadro gjatë zbatimit të tij kishte degraduar, duke u shndërruar në fond për pozita menaxheriale.*

Në shtator 2015, Instituti GAP publikoi një analizë e cila vë në pah degradimin e Fondit

për Kuadro dhe jep rekomandime se si të evidentohen keqpërdorimet me këtë fond gjatë ndarjes së tij për vitin 2015.
Rekomandimet e analizës i janë dërguar të gjitha ministrive. Me qëllim të qartësimit të rekomandimeve të Institutit GAP, hulumtuesit e Institutit GAP janë ftuar në takime të drejtpërdrejta me përgjegjësit e Ministrisë së Administratës Publike, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Integrimeve Evropiane.

## 3.3 Ndarja e përgjegjësive në inspektim në mes të nivelit qendror dhe lokal – shembulli i inspektoratit të tregut dhe inspektoratit sanitar




Inspektoratet janë trupat më të rëndësishme për zbatimin e ligjeve në fuqi. Mirëpo, këto trupa ezketutive përballen me vështirësi të mëdha sa i përket funksionimit të tyre.

Në vitin 2014, Instituti GAP ka publikuar një raport të gjerë për gjendjen e të gjitha inspektorateve në Kosovë. Të gjeturat e raportit janë prezantuar si rekomandime për përmirësimin e Ligjit për Inepsktorate, i cili është pjesë e agjendës legjislative tani e disa vite.

Në korrik 2015, Instituti GAP ka publikuar një analizë e cila trajton problemin e kompetencave në mes të nivelit qendror dhe atij lokal, sidomos sa i përket inspektoratit të tregut dhe atij sanitar. Të gjeturat e kësaj analize i janë përcjellur Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për t'u përfshirë në draftin e fundit të Ligjit për Inspektoratet.

## 3.4 Konferencë "Sfidat e Reformës së Administratës Publike në Kosovë", 23 nëntor 2015



**Organizuar nga: OECD/SIGMA, Komisioni Evropian, KCSF**

Instituti GAP ka marrë pjesë në këtë konferencë me rëndësi për reformën e administratës publike dhe ka qenë pjesë e prezantimit në panelin e shoqërisë civile mbi këtë temë. Instituti GAP ka prezantuar para përfaqësuesve të OECD/SIGMA, Komisionit Evropian dhe Ministrit të Administratës Publike propozimin e Institutit GAP të zhvilluar në analizë të politikave për reformën e administratës publike mbi mënyrën e uljes së numrit të të punësuarve në sektorin e publik, dhe mënyrën e zvogëlimit të administratës publike si strukturë. Në këtë konferencë është prezantuar mbi reformat e ndërmarra në Kosovë konform Parimeve mbi Administratën Publike në Kosovë të zhvilluar nga OECD/SIGMA.

## 3.5 Konferencë "Reforma e Administratës Publike: sa mund të jenë ndryshimet në Ligjin për Shërbimin Civil zgjidhja? Një perpspektivë e Shoqërisë Civile", 26 nëntor 2015



**Organizuar nga: Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti GAP**

